


## Vaksinat Covid – Informacion i nevojshëm

25 Mars 2021

### Marrja e vaksinës: ka të bëjë vetëm me mbrojtjen tuaj



Falë vaksinave, trupi juaj mëson të njohë Covid dhe të mbrohet.



Vaksinat Covid janë shumë efektive në **mbrojtjen ndaj formave të rënda** të Covid-19

**Vaksinat janë falas për këdo.**



### Ku mund të vaksinoheni?

Ju mund të vaksinoheni:

- Në një **qendër vaksinimi**  
 800 009 110    w  [santé.fr](http://santé.fr)
- Te **mjekët tuaj**, në **farmacinë tuaj lokale** ose në **qendrën tuaj të kujdesit shëndetësor**
- Në **vendin tuaj të punës** nëse punoni në një institucion të kujdesit shëndetësor



### A keni pyetje?

Pyesni një profesionist të kujdesit shëndetësor, një punonjës social, në *mairie*-në tuaj (bashkinë e qytetit)



ose në



Për t'u vaksinuar, telefononi në:



**0 800 009 110**

(pa pagesë)

ose në



## Vaksinat Covid – Pyetjet e mia


**Nëse kam një gjendje shëndetësore (si p.sh. diabet, kancer ose një gjendje të pazakontë), a mund të vaksinohem?**



**✓ Po**

**Nëse keni një gjendje shëndetësore, duhet të vaksinoheni** sepse ju mund të infektoheni lehtësisht nga një formë e rëndë dhe fatale e Covid-19. Vakina do ju ndihmojë ta luftoni virusin.

**Nëse e kam kaluar Covid-19, a duhet të vaksinohem?**



**✓ Po**

**Edhe nëse e keni kaluar Covid-19, ju duhet të vaksinoheni.** Ju mund ta bëni këtë midis muajit të tretë dhe të gjashtë pas infektimit, me vetëm një dozë (në vend të dy dozave).

**Nëse jam vaksinuar, a mund të kthehem në gjendje normale dhe të heq maskën?**



**✗ Jo**

**Edhe nëse jeni vaksinuar, duhet të vazhdoni të mbani maskën dhe të merrni masa mbrojtëse** derisa e gjithë popullata të jetë vaksinuar.

**Nëse jam vaksinuar, a mund të udhëtoj lehtësisht?**



**✗ Jo**

**Edhe nëse jeni vaksinuar, duhet të bëni një analizë PCR-je 72 orë përpara udhëtimit,** derisa e gjithë popullata të jetë vaksinuar. Kjo analizë është falas dhe nuk shoqërohet me dhimbje. Ju duhet të kontrolloni rregullat e secilit vend përpara se të udhëtoni.